

OJQ "Durmish Asllano" Prizren

Raporti i audituesit të pavarur
Pasqyrat financiare për vitin 2024

PËRMBAJTJA:

Raporti i rishikimit nga audituesi i pavarur	3-4
Pasqyra e pozitës financiare	5
Pasqyra e te ardhurave	6
Pasqyra e rrjedhës së parasë	7
Pasqyra e bilancit të fondeve	8
Shënimet e pasqyrave financiare	9-11

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për: Bordin drejtues të OJQ “Durmish Asllano” Prizren

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të OJQ “Durmish Asllano” (‘Organizata), që përbëhen nga pasqyra e pozitës financiare për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2024, pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve, rrjedha e parasë dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Organizatës me 31.12.2024, aktivitetet operative dhe rrjedhën e parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, në përputhje me bazën kontabël të përshkruar në Shënimin 2.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare të këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga Organizata në pajtueshmëri me kërkesat etike që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike në pajtueshmëri me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e përftuara të auditimit janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar një bazë për opinionin tonë.

Theksimi i çështjes – baza e kontabilitetit dhe kufizimi i shpërndarjes dhe përdorimit

Ju tërheqim vëmendjen në Shënimin 2 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan bazën e kontabilitetit. Këto pasqyra financiare janë përgatitur për të ndihmuar Organizatën që të jetë në pajtueshmëri me dispozitat e raportimit financiar sipas kërkesave të donatorëve dhe kontratave të financimit. Raporti ynë i drejtohet vetëm OJQ “Durmish Asllano”-Prizren dhe donatorëve si dhe rregullatorit përkatës, dhe rrjedhimisht pasqyrat financiare mund të mos jenë të përshtatshme për ndonjë qëllim apo përdorim nga ndonjë palë tjetër që nuk është e lartcekur. Opinioni ynë nuk është modifikuar sa i përket kësaj çështje.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrën financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me kontabilitetin e bazuar në arkëtime dhe pagesa me para të përshkruar në Shënimin 2; kjo përfshinë përcaktimin nëse baza e kontabilitetit në arkëtim dhe pagesë me para është bazë e pranueshme në përgatitjen e pasqyrës financiare në këto rrethana dhe për kontrole të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrës financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Organizatës të vijoje sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likujdojë ose të ndërpresë aktivitetet e Organizatës, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër reale përveç të veprojë në këtë mënyrë.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrës financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyra financiare si tërësi nuk përmban anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këtë pasqyrë financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrës financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojme evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojme njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijnë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënëse të auditimit, përfshirë çfarëdo mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

A.O. "Audit AK" Shpk
Bekim Bytyçi, partner



Prizren, 05 Qershor 2025

OJQ "Durmish Asllano", Prizren
Pasqyra e pozitës financiare
më 31 dhjetor 2024

	Shënimi	2024 €	2023 €
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	39,552	13,615
Pasuritë e tjera afatshkurtra	4	4,897	
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		44,449	13,615
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	5	7,630	1,890
Gjithsej pasuritë afatgjata	5	7,630	1,890
GIJTHSEJ PASURITË		52,079	15,505
Detyrimet dhe Fondet			
Detyrimet afatshkurtra			
Mbitërheqja bankare			528
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	7		1,362
Detyrimet e tjera afatshkurtra	7		
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		-	1,890
Detyrimet afatgjata			
Detyrimet e tjera afatgjata		-	-
Gjithsej detyrimet afatgjata		-	1,890
Gjithsej detyrimet		-	
Fondet			
Net rritje/pakësim të fondeve nga periudhat e kaluara		13,615	11,997
Net rritje/pakësim të fondeve nga periudha vijuese		38,464	1,618
Gjithsej fondet		52,079	13,615
TOTALI I FONDEVE DHE DETYRIMEVE		52,079	15,505

Pasqyrat financiare janë hartuar nga menaxhmenti dhe janë aprovuar si dhe nënshkruar me 31.03.2025.
Shënimet shpjeguese nga f. 9-11 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Drejtori

(emri dhe mbiemri, nënshkrimi)



Drejtori financiar

(emri e mbiemri, nënshkrimi)

OJQ "Durmish Asllano", Prizren
Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024

	Shënim	€ 2024	€ 2023
Të hyrat	8	148,997	76,418
Fitimi / (humbja) bruto		148,997	76,418
Shpenzimet e pagave	9	75,179	41,404
Shpenzimet operative	10	34,250	33,187
Shpenzimet e tjera	5	1,104	210
Totali i shpenzimeve		110,533	74,800
Rritje/pakësim i fondeve		38,464	1,618
Net rritje / pakësim i fondeve nga periudhat e kaluara		13,615	11,997
Fondet në fund të vitit		52,079	13,615

Drejtori

(emri dhe mbiemri, nënshkrimi)



Drejtori financiar

(emri e mbiemri, nënshkrimi)

OJQ "Durmish Asllano" Prizren		
Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024		
Përshkrim	2024	2023
	€	€
METODA INDIREKTE		
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Teprica/Mungesa neto për vitin	38,464	1,618
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave		
Zhvlerësimi i pronës	1,104	210
	39,568	1,828
Lëvizjet në pasuritë dhe detyrimet qarkulluese		
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera		
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe		
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	-4,897	
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	-528	528
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	-1,362	1,362
	-6,787	1,890
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative	32,781	3,718
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e pajisjeve	-6,845	-2,100
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investues	-6,845	-2,100
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese	0	0
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë	25,936	1,618
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	13,615	11,997
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	39,552	13,615

OJQ "Durmish Asllano" Prizren

Pasqyra e ndryshimeve në fonde për vitin që përfundon me 31.12.2024

	Teprica/Mungesa e akumuluar		Gjithsej
	€	€	€
Gjendja më 1 janar 2023	-	11,997	11,997
Rritje/pakësim për vitin	-	1,618	1,618
Gjendja më 31 dhjetor 2023	-	13,615	13,615
Rritje/pakësim për vitin	-	38,464	38,464
Gjendja më 31 dhjetor 2024	-	52,079	52,079

1. HYRJE

Historiku dhe politikat operative

OJQ "DURMISH ASLLANO" është Organizatë Joqeveritare, me seli në Prizren, e regjistruar në Ministrinë e Administratës Publike me 04.05.2001 sipas rregullativës ligjore në fuqi. Aktivitetin e saj e zhvillon me nr. të regjistrimit 5100703-4 dhe me nr. fiskal 600216536. Selia e Organizatës është në adresën rr. Joni Lamela 2, nr. 20, Prizren.

OJQ "DURMISH ASLLANO" ka në programin e saj aktivitetet si në vijim:

- Promovimit të kulturës, traditës dhe gjuhës Rome;
- Informim adekuat në gjuhën Rome;
- Fuqizimin e të rinjve dhe angazhimin e tyre për qytetari aktive;
- Promovimin dhe respektimin e barazisë gjinore;
- Mirëqenia sociale e komunitetit Rom.
- Edukimi kulturor, etj.

2. Bazat e përgatitjes dhe politikat kontabël

Për qëllime të raportimit financiar, Organizata përdor metodën e parasë së gatshme (bazën cash) për raportim mbi pranimin dhe shpenzimin e fondeve. Asetet fikse regjistrohen si pasuri ose si shpenzime në momentin e blerjes së tyre.

3. Valuta funksionale dhe raportuese

Të gjitha raportet janë të shprehura në Euro, e cila është valuta funksionale e organizatës.

4. Të hyrat

Të hyrat njihen deri në masën që është e mundshme që përfitimet ekonomike do të rrjedhin për organizatën dhe të hyrat mund të maten me besueshmëri. Të hyrat e organizatës janë kryesisht të ardhura nga donatorët. Organizata njej të hyrat në momentin e arkëtimit të mjeteve.

5. Tatimet

Organizata i nënshtrohet tatimit në fitim të shkallës 0% në fitim sipas Ligjit të Asociimit e organizatave joqeveritare 06/L-043. Për këtë arsye nuk ka ndonjë shpenzim të tatimit të paraqitur në pasqyrat financiare.

6. Pajisjet

Pajisjet janë matur me kosto minus zhvlerësimi i akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga dëmtimi (rënia në vlerë).

Zhvlerësimi ngarkohet në mënyrë që të ndahet kosto e pasurive minus vlera e tyre e mbetur përgjatë jetës së përdorimit të parashikuar, duke përdorur metodën lineare. Normat vjetore të mëposhtme janë përdorur për zhvlerësimin e pajisjeve:

Pajisjet, mobilieritë, kompjuterët 20 %

Nëse ka një tregues se ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në normën e zhvlerësimit, jetën e dobishme ose vlerën e mbetur të një pasurie, zhvlerësimi i kësaj pasurie rishikohet në mënyrë prospektive për të pasqyruar pritshmëritë e reja.

7. Shpenzimet

Të gjitha shpenzimet/daljet e ndodhura njihen në momentin e pagesës.

3. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

	31.12.2024	31.12.2023
	€	€
Paraja në arkë		
Paraja në bankë-PCB	39,552	13,615
	39,552	13,615

4. Pasuritë tjera afatshkurtra

	31.12.2024	31.12.2023
	€	€
Të arkëtueshmet tjera (Parapagimet)	4,897	
	4,897	

5. Pajisjet

Përshkrimi	Pajisjet, inventari, kompjuterët	Totali
a) Kosto		
Më 1 janar 2023		
Shtesat gjatë vitit	2,100	2,100
Shitjet/shlyerjet gjatë vitit		
Me 31.12.2023	2,100	2,100
Shtesat	6,845	6,845
Shlyerjet/shitjet gjatë vitit		
Me 31.12.2024	8,945	8,945
b) Zhvlerësimi i akumuluar		
Gjendja me 01.01.2023		
Zhvlerësimi i vitit	210	210
Shitjet/shlyerjet gjatë vitit		
Me 31.12.2023	210	210
Zhvlerësimi i vitit	1,104	1,104
Shitjet/shlyerjet gjatë vitit		
Më 31.12.2024	1,314	1,314
c) Vlera neto		
Me 31.12.2023	1,890	1,890
Me 31.12.2024	7,630	7,630

7. Llogaritë e pagueshme tjera

	31.12.2024	31.12.2023
	€	€
Të pagueshmet tjera-Tatimet dhe kontrib. pensionale		1,362
Të pagueshmet tjera		528
		1,89

8. Të hyrat dhe shpenzimet sipas projekteve

Projektet	Të hyrat	Shpenzimet	Mbetja
Projekti: 01. ZKGJ.24	4,000	4,000	
Projekti 02. AA- 23/24	41,206	20,554	20,652
Projekti: 03 BC	11,746	11,746	0
Projekti: 04. CHW8	3,000	3,000	
Projekti: 05. DKRS.24	7,000	6,999	1
Projekti: 06. MKK23/24	19,574	19,574	
Projekti: 07.OSCE	2,000	100	1,900
Projekti: 08. Shfaqja Gogle Love	7,100	7,099	1
Projekti: 09. TDH	15,000	9,173	5,827
Projekti: 10. Presidenca	2,000	2,000	0
Projekti: 11. EED	21,872	21,872	
Projekti: 12. KEC	500	500	
Projekti: 13.MKRS24/25	13,999	3,917	10,082
Gjithsej	148,997	110,533	38,464

9. Shpenzimet e pagave

	Për vitin që përfundon me 2024	Për vitin që përfundon me 2023
	€	€
Pagat neto	63,079	35,471
Tatimi ne paga	4,939	2,076
Kontributi i puntorit	3,580	1,928
Kontributet e punëdhënësit	3,579	1,928
	75,179	41,404

10. Shpenzimet operative dhe administrative

	Për vitin që përfundon me 2024	Për vitin që përfundon me 2023
	€	€
Shfrytëzimet e zyrës, internetit, telefonit, etj.	34,250	33,187
	34,250	33,187

11. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese

Nuk ka ngjarje pas datës së bilancit të gjendjes që do të kërkonte të bëhen korrigjime në pasqyrat financiare të vitit raportues.

12. Aprovimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga menaxhmenti dhe janë autorizuar për publikim më 31.03.2025.